



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRIË - OPŠTINA VUČITRAN	
02 Nr. / Br	1259/19
Nr. i ligj. / Dr. st	
Data: / Datum	06.11.2019
VUSHTRRI - VUČITRAN	



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Bazuar në nenin 1 dhe 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 4 paragrafi 2, pika 2.4. nënpika 2.4.3, nenit 7 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, Nr. 03/L-139 me ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr.03/L-205 të datës 28.10.2010, si dhe nenit 67 "g" të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës si organ shpronësues me datën 06.11.2019 merr këtë:

V E N D I M  
PËR FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHPRONËSIM TË PRONAVE TË  
PALUEJTSHME

**Neni 1**

Fillohet procedura e shpronësimit të pronave të paluejtshme të pronarëve privat/zotëruesve të interesit, për qëllim të interesit publik – realizimi i projektit për ndërtimin e rezervuarit të ujit (Basenit) në fshatin Taraxhë, Komuna Vushtrri, për pjesën e parcelave kadastrale si në vijim:

- P-70202064-00083-0, në sipërfaqe prej **1027 m<sup>2</sup>**, nga sipërfaqja e përgjithshme prej 8981 m<sup>2</sup>, ZK-Taraxhë, pronar në pjesë ideale 1/1 Emin (Selim) Selimi nga fshati Taraxhë, Komuna Vushtrri.
- P-70202064-00085-0, në sipërfaqe prej **502m<sup>2</sup>**, nga sipërfaqja e përgjithshme prej 18313m<sup>2</sup>, ZK Taraxhë, pronar në pjesë ideale 1/1 Hasan (Emin) Selimi, nga fshati Taraxhë, Komuna Vushtrri.

**Neni 2**

Shpronësimi i pjesëve të parcelave kadastrale të cekur në pikën 1 të këtij vendimi bëhet me kompensim, konform dispozitave të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme.

**Neni 3**

Vlerësimin për kompensimin e shpronësimit e bën Zyra për Vlerësim të Pronës së paluajtshme pranë Ministrisë së Financave të Kosovës.

#### Neni 4

Me këtë vendim të njoftohen Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit, Drejtoria për Buxhet dhe Financa si dhe pronarët/zotëruesit e interesit të parcelave që do të shpronësohen.

#### Neni 5

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga organi shpronësues.



Kryetari i Komunës  
*Xhafer Tahiri*  
Xhafer Tahiri

REPubLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUÇITRAN

02 Nr. / Br. 1273/19

Nr. i fq. / Br. sh.

Data: / Datum 13. 11. 2019

VISHTRRI - VUÇITRAN



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI  
Kryetari



Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67 “g” të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

1. Lejohet pagesa e faturavës nr. 810549107 datë 05.11.2019, në shumë prej 23.80 € (njëzetetreeuroetëdhjetë cent), me rastin e shpenzimeve të krijuara në “Mising” në Vushtri (ushqim dhe pije freskuese) me profesorë nga SHBA.
2. Pagesa e shumës së cekur në pikën paraprake të këtij vendimi të bëhet nga buxheti i Zyrës së Kryetarit të Komunës.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

  
Xhafer Tahiri  
Kryetar i Komunës

Vendimi iu dërgohet:

- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- Arkivit të Sekretarisë.



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI  
Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 1 paragrafi 5 të Udhëzimit Administrativ Nr. 06/2010 për Mënyrën dhe Procedurat e Shitjes së Trungjeve Pyjore dhe Asortimenteve Drusore nga Pyjet Publike, nenin 67 “g” të Statutit të Komunës si dhe në bazë të propozimit nr. ref.37/2019 datë 15 nëntor 2019 të Drejtorisë për Ekonomi Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

1. Lejohet shitja përmes procedurave të tenderimit e masës drusore në sasi prej 95.95 m<sup>3</sup> të konfiskuar nga organet kompetente, e cila gjendet në depon e sektorit të pyjeve – ambientet e Njësisë së Zjarrfikësve në Vushtri, në vendosje të përkohshme.
2. Obligohet Drejtoria për Ekonomi bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural që të inicoj procedurat e tenderimit për shitje të masës drusore të cekur në pikën paraprake të këtij vendimi, konform rregullave dhe procedurave të parapara ligjore.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Xhafer Tahiri  
Kryetar i Komunës

Vendimi iu dërgohet:

- Drejtorisë për ekonomi Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural
- Arkivit të Sekretarisë.





REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRISË - OPŠTINA VUÇITEN

UZ Nr. / Br. 1349 / 19

Nr. i fq. / Br. st.

Data: / Datum 29. 11. 2019

VUSHTRRI - VUÇITEN

REPUBLICA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI



Në pajtim me nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-040, nenin 67 "P" dhe "g" të Statutit të komunës, si dhe bazuar në situatën e krijuar nga ardhjet në komunën e Vushtrrisë të shtetasve nga Republika e Shqipërisë të goditur nga tërmeti i datës 26 nëntor 2019, Kryetari i Komunës merr këtë:

VENDIM  
PËR FORMIM TË KOMISIONIT

1. Formohet komisioni për evidentim të shtetasve nga Shqipëria të cilët kërkojnë strehim në Komunën e Vushtrrisë, në këtë përbërje:
  - 1.1 **Bajrush Kosumi**, Drejtor i DMSH-së, kryesues,
  - 1.2 **Besim Muzaqi**, Nënkyetar i Komunës, anëtar
  - 1.3 **Mehmet Selaci**, Drejtor i Administratës, anëtar,
  - 1.4 **Afrim Namani**, D i Arsimit, anëtar,
  - 1.5 **Sylejman Mehulli**, Drejtor i Shëndetësisë dhe Përkujdesjes Sociale, anëtar,
  - 1.6 **Amir Haradinaj**, Shef i Kabinetit të Kryetarit, anëtar
  - 1.7 **Shaban Salihu**, Policia e Kosovës, anëtar
  - 1.8 **Blerim Zhabari**, Zyrtar për informim, anëtar,
2. Komisioni në përbërje të cekur si në pikën paraprake të këtij vendimi do të bëjë evidentimin e shtetasve nga Republika e Shqipërisë të goditur nga pasojat e tërmetit në rrethinën e Durrësit, Thumanë dhe vendet tjera për rreth të cilët kanë ardhur apo do të vijnë për të gjetur strehim në Komunën e Vushtrrisë.
3. Komisioni në fjalë do të ndihmoj në rastet kur ka nevojë, për akomodim në familjet pranuese të komunës.
4. Komisioni gjithashtu do të evidentoj të gjitha familjet nga Komuna jonë të cilët kanë akomoduar ose do të akomodojnë në shtëpitë e tyre shtetasit nga Shqipëria.
5. Komuna të publikoj njoftimin publik për nevojën e paraqitjes për regjistrim të të ardhurveve nga Shqipëria në komunën e Vushtrrisë
6. Drejtori i Administratës do të caktoj një zyrtar nga kjo drejtori për pranim përkatësisht evidentim të të ardhurveve nga Shqipëria. Në këtë rast, të gjithë të paraqiturëve duhet të iu merren të dhënat personale të cilat do të shënohen në formular që do ta krijoj Drejtoria për Administratë.
7. Vendimi hyn në fuqi menjëherë.

Kryetari i Komunës  
Xhafer Tahiri